



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage

FORMULAR PROPOZIMI

**Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje të Përhershme
Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturale, Peizazh kulturor**

EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR

Shtëpi banimi (IMMK)



Datimi/et (Relativ/e)

Periudha/t historike Shek. XIX

Shek. XIX

Adresa: Vendndodhja, Qyteti/Fshati, Komuna

Rr. Zenel Salihu Prishtinë, Prishtinë

Lloji i asetit të propozuar

Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore

Nënkategoria: Monument

Numri unik 003084

Numri i regjistrimit në KKTK

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/referenca e dokumentit/aktit nëse ka

Nr.i vendimit 731/1957

Nën Mbrojtje të Përkohshme 2011, 2012,2013,2014,2015

ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

Shtëpia ku sot është i vendosur Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve të Kosovës daton nga gjysma e dytë e shekullit XIX. Kjo shtëpi paraqet një nder shembujt më të rëndësishëm dhe tipik të arkitekturës qytetare të banimit dhe paraqet vlera të rëndësishme arkitekturale, historike dhe kulturore të banimit dhe jetesës për tere regjionin Kosovës dhe Ballkan.

Kriteret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar aseti

Vlerat historike- Ndërtesa është e ndërtuar ne gjysmën e dyte te shekullit XIX , e ndërtuar nga Maliq Pasha një zotëri feudal nga Kosova. Ne dekadat e fundit te këtij shekulli ka qenë e vendosur administrata e parë e Vilajetit të Kosovës, ne te njëjtën kohe aty ka funksionuar edhe shtypshkronja e tyre. Ne vitin 1957 ndërtesa është blere nga Enti Krahinorë dhe ka qene ne gjendje jo te mire, mirëpo me intervenimet konservuese te sajë është shpëtuar nga shkatërrimi i sigurt, me ç'rast i është kthyer pamja e saj fillestare, autentike.

Vlera artistike- Ndërtesa posedon vlera te larta estetike si ne eksterier po ashtu edhe ne enterier. Konstruksioni i dyshemesë është me trarë të drurit të mbuluar me dërrasa në të gjitha kthinat, përpos hollit të përdhese, i cili është i shtruar me gurë kalldrëm. Të gjitha dyert, si ato një krahësh dhe dykrahëshe, janë të punuara nga druri masiv dhe janë punim i mëvonshëm; vetëm dera që çon nga hollit në korridorin e ngushtë nga ana perëndimore është autentike. Muret janë të gëlqerosura. Dritaret janë drejtkëndëshe prej druri me qepena druri dhe në përdhese janë të mbuluara me rrjetë të punuar prej qeparëve të drurit të quajtura “tolpija”. Brendësia dhe mobilieria janë të kohës më të re por të përshtatura me stilin origjinal që karakterizohet me ulëset e asaj kohe –minderet, të mbuluara me qilima, dollapët e thellë në mur me kapakë druri dhe raftet prej druri dhe mangalli.

Vlera shkencore - Ndërtesa paraqet një dëshmi faktike për te zhvilluar studime shkencore rreth sistemit te ndërtimit; teknikave te ndërtimit; studim te materialeve te ndërtimit, studim ne fushën e etnologjisë, sociologjisë; kulturës se jetesës dhe kulturës ne përgjithësi.

Vlera shoqërore - Krahas vlerave historike, teknike, arkitektonike, shkencore dhe artistike ndërtesa ka vlere te madhe materiale dhe shoqërore, të dy këto lloje vlerash qe përmbushen në mënyrë reciproke. Ndërtesa është dëshmi e vlerave te shumta të natyrës shpirtërore, si dinjiteti njerëzor, mikpritja, besnikëria, si vlera morale që janë krijuar në epokat e mëparshme te cilat mbesin edhe sot aktuale.

Propozuesi:

Institucioni: *Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prishtinë,*
Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

Emri/Mbiamri: *Edona Durguti* Nënshkrimi

Adresa dhe kontakti: *Rr. Agim Ramadani, 10,000 Prishtinë*
Tel: 038 244 501
Mob. +37749 448 297
Email: edona.durguti@rks-gov.net

Data :/..../.....

Bashkëngjitur: Lista e të dhënave dhe dokumentacioni

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit
2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit
5. Dokumentacioni përcjellës

Pranimi

Nr. protokollit .../.../... Dt..../.../.....

Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa

Rr. Zenel Salihu, Prishtinë, Prishtinës

Qyteti i Prishtinës shtrihet në pjesën Juglindore të Kosovës, në lartësi mbidetare prej 500 metrave. Duke pasur pasuri natyrore dhe pozitë të rëndësishme gjeografike, është edhe udhëkryq i rrugëve nga Perëndimi, Lindja dhe Veriu i Ballkanit. Historia e këtij regjioni daton prej mileniumit të IV para lindjes së Krishtit, Neolitit, epokës së gurit dhe bronzit.

Për herë të parë Prishtina përmendet në kontaktet raguziane të shek XIII. Në fund të shekullit të XIV, gjatë sundimit Otoman, Prishtina u zhvillua si një vend urban me ndikim oriental me tipe të ndryshme të ndërtesave, si: Xhamia, hamame, shitore dhe shtëpi. Ishte vend i rëndësishëm për kulturë, art, tregti, religjion dhe rrugë për karvanë (caravan routes).

Prishtina pas Luftës së Dytë Botërore, u bë qytet i rëndësishëm si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë administrativo-politik, që solli deri te shpallja e saj si qendër administrative e Kosovës më 1947. Gjatë 50 viteve të fundit, qyteti i vjetër ka pasur një zhvillim të shpejtë dhe të pakontrolluar, por një numër i ndërtesave të rëndësishme janë ende të ruajtura.

Shtojcë 1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituda (KosovaNewRef I)

N – 42° 39' 56.47"

E- 21° 10' 7.35"

Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëzim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Shtëpia e banimit (IMMK) gjendet në anën e majtë udhëkryqit të rrugës Zenel Salihut dhe rrugës Rustem Hyseni në qytetin e Prishtinës në parcelën Kadastrale 5573 dhe është në zonën e ngushtë kulturo – historike të qytetit.

Kufizohet me SH. F. Elena Gjika.

Perimetri i asetit të propozuar: 0.1987 ha

Zona rrethuese për mbrojtje/Buffer zone: _____ ha

Sipërfaqja totale: _____ ha

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- *Planet e situacionit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese P=1:500 dhe 1:200 (nëse është e aplikueshme).*
- *Planet kadastrale të asetit të propozuar për mbrojtje.*
- *Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës së mbrojtur rreth tij (buffer zone), gjeoreferencat në min. tri pika, koordinatat, shënimi i përpjesës, orientimi, projekcioni, emri i pronarit dhe data.*
- *Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.*

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratigrafinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

Kjo shtëpi paraqet shembull tipik të arkitekturës qytetare të shek. XIX. Në këtë objekt ka qenë e vendosur administrata e parë e Vilajetit të Kosovës. Shtëpia ku sot është i vendosur Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve të Kosovës daton nga gjysma e dyte e shekullit XIX. U ndërtuar nga Maliq Pasha një zotëri feudal nga Kosova, dhe sot është në mbrojtje te shtetit si një ndër shembujt më interesant të tipologjisë së arkitekturës qytetare te banimit ne Kosove. Në dekadat e fundit të shek. 19të në shtëpi ka qenë e vendosur administrata e parë e Vilajetit të Kosovës, ne të njëjtën kohe aty ka funksionuar edhe shtypshkronja e tyre. Në vitin 1957 kur ndërtesa u ble nga

Enti Krahinorë, ajo ishte në gjendje të keqe, mirëpo me intervenimet e bëra menjëherë është shpëtuar nga shkatërrimi i sigurt me ç'rast i është kthyer pamja e saj fillestare.

Shtëpia ka pas oborr shume të gjere të ndarë në 'haremllek' dhe 'selamllëk'. Fasada ballore është e orientuar kah jugu dhe oborri i rregulluar bukur i rrethuar me mure te mbuluar me tjegulla tradicionale (qeremide).

Ndërtesa është simetrike, me planimetri drejte këndesh me etazhitet P+1. Në fasadë ballore ka çardak të mbyllur, ndërsa shtëpia ka mure të trasha prej qerpiçi. Muret e përparme të katit në dalin 30 cm nga rrafshi i murit për të formuar kurorën që thyen monotoninë dhe zbukuron ndërtesës.

Kulmi ka rënie të vogël me strehe të gjerë me dim.120 cm dhe mbulese prej qeremideve . Nga hyrja kryesore e oborrit deri te veranda 'hajati' shtëpisë, arrihet përmes shtegut te shtruar me gurë 'kallderm'.Nga veranda përmes dyerve dy kriheshe hyhet në holl ku gjendet vatra.

Në anën e majtë nga holli, përmes një korridor të ngushte, arrihet te kthina sanitare. Nga të dy anët e këtij koridori te ngushte gjendet edhe nga nja kthinë.Në 'divanhane', në kat, arrihet përmes shkalleve një kriheshe të punuara nga druri. Radhitja e kthinave në kat është e njëjët me radhitjen e kthinave në përdhese. Konstruksion i dyshemesë është me trarë të drurit mbuluar me dërrasa në të gjitha kthinave, përpos hollit të përdhësës i cili është i shtruar me gur 'kallderm'.

Te gjitha dyert, si ato një kriheshe dhe dy kriheshe, janë të punuara nga druri masiv dhe janë punim i më vonshëm; vetëm dera që qon nga holli në korridorin e ngushte nga ana perëndimore është autentike.

Muret janë të gëlqerosura,dritaret janë drejtkëndëshe prej druri me grila prej druri dhe në përdhese janë të mbuluara me rrjetë të punuar prej qeprave të drurit të quajtura 'tolpija'.

Brendësia dhe orendite janë te kohës më të re por të përshtatura me stilin origjinal që karakterizohet me ulëset e asaj kohe 'minderet' të mbuluar me qilima , dollapët e thella prej druri 'yklyqet',raftet prej druri dhe 'mangalli'.

Shtojcë 3: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.

Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës

Funksioni (përdorimi) aktual: Ndërtesa është ne funksion te Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve të Kosovës (IMMK)

Shfrytëzuesi/t/: IMMK

Pronësia e ndërtimeve dhe tokës: Pasuri Shoqërore, Enti Krahinorë për mbrojtjen e përmendoreve

Zhvillimi historik dhe kronologjik i asetit

- Përshkrimi i formësimit të asetit nga themelimi deri në gjendjen aktuale, duke specifikuar ndryshimet, transformimet, demolimet apo rindërtimet domethënëse në historinë e konservimit.

- Ndërlidhur me asetet e trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike, të bëhet paraqitja e fazave kryesore ndërtimore për: monumente, ansamble, fusha të konzervimit arkitektural, lokalitete dhe rezervate. Peizazhi kulturor, të përshkruhet sipas të dhënave të lartë shënuara, duke përfshirë aspektin e historisë dhe kronologjisë së aktiviteteve njerëzore në mjedisin natyror.
- Shtëpia e banimit (IMMK) është ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. XIX për sunduesin e Kosovës Maliq Pashën.
- Në vitet e fundit të shek. XIX. Ka qenë e vendosur administrata e Vilajetit të Kosovës.
- Në të njëjtën kohë ka puna edhe shtyp shkronja e tyre.
- Vitin 1957 është blerë nga Enti Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve me intervenime restauruese konservuese i kthehet dukja e ma hershme. Po në këtë vit ka hyr nën mbrojtje të përhershme.
- Sot në këtë shtëpi është vendosur Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës.

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

Shtëpia ku sot është i vendosur Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve të Kosovës daton nga gjysma e dytë e shekullit XIX. Kjo shtëpi paraqet një nder shembujt më të rëndësishëm dhe tipik të arkitekturës qytetare të banimit dhe paraqet vlera të rëndësishme arkitekturale, historike dhe kulturore të banimit dhe jetesës për tere regjionin Kosovës dhe Ballkan. Ndërtesa në përgjithësi ka ruajtur formën dhe një pjesë të materialit origjinal dhe është në gjendje të mirë fizike.

Vlerat historike- Ndërtesa është e ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX, e ndërtuar nga Maliq Pasha një zotëri feudal nga Kosova. Në dekadat e fundit të këtij shekulli ka qenë e vendosur administrata e parë e Vilajetit të Kosovës, në të njëjtën kohë aty ka funksionuar edhe shtypshkronja e tyre. Në vitin 1957 ndërtesa është blerë nga Enti Krahinorë dhe ka qenë në gjendje jo të mirë, mirëpo me intervenimet konservuese të sajë është shpëtuar nga shkatërrimi i sigurt, me ç'rast i është kthyer pamja e saj fillestare, autentike.

Vlerat artistike- Ndërtesa posedon vlera të larta estetike si në eksterier po ashtu edhe në enterier. Konstruksioni i dyshemesë është me trarë të drurit të mbuluar me dërrasa në të gjitha kthinat, përpos hollit të përdhesisë, i cili është i shtruar me gurë kalldrëm. Të gjitha dyert, si ato një krahësh dhe dykrahëshe, janë të punuara nga druri masiv dhe janë punim i mëvonshëm; vetëm dera që çon nga hollit në korridorin e ngushtë nga ana perëndimore është autentike. Muret janë të gëlqerosura. Dritaret janë drejtkëndëshe prej druri me qepena druri dhe në përdhese janë të mbuluara me rrjetë të punuar prej qeparëve të drurit të quajtura "tolpija". Brendësia dhe mobilieria janë të kohës më të re por të përshtatura me stilin origjinal që karakterizohet me ulëset e asaj kohe –minderet, të mbuluara me qilima, dollapët e thellë në mur me kapakë druri dhe raftet prej druri dhe mangalli.

Vlerat shkencore - Ndërtesa paraqet një dëshmi faktike për të zhvilluar studime shkencore rreth sistemit të ndërtimit; teknikave të ndërtimit; studim të materialeve të ndërtimit, studim në fushën e etnologjisë, sociologjisë; kulturës së jetesës dhe kulturës në përgjithësi.

Vlerat shoqërore - Krahas vlerave historike, teknike, arkitektonike, shkencore dhe artistike ndërtesa ka vlera të madhe materiale dhe shoqërore, të dy këto lloje vlerash që përmbushen në

mënyrë reciproke. Ndërtesa është dëshmi e vlerave të shumta të natyrës shpirtërore, si dinjiteti njerëzor, mikpritja, besnikëria, si vlera morale që janë krijuar në epokat e mëparshme të cilat mbesin edhe sot aktuale.

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

- *Përshkrimi i gjendjes teknike: Ndërtesa në përgjithësi ka ruajtur formën dhe një pjesë të materialit origjinal dhe është në gjendje të mirë fizike, konstruksioni i kulmit dhe mbulesa janë të dëmtuara dhe pikon në disa vende. Po ashtu në përdhës ka lagështi*
- *Faktorët ndikues ndaj asetit: Faktori njeri, mos mirëmbajtja sistematike, ndërtimet e reja, e tij.*

5. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- *Fotografi dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).*
- *Kopje e Aktit të mëhershëm mbi statusin ligjor të asetit.*
- ***Shtojcë 1**, A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- ***Shtojcë 2**, Planet e situacionit të asetit me shenjzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese, P=1:200 dhe P=1:500, në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Plani kadastral i asetiit të propozuar për mbrojtje dhe zonës rreth tij, me paraqitjen e të dhënave për parcelat, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.*
- *Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës rreth tij (buffer zone), në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.*
- ***Shtojcë 3:** Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në P= 1:200, përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.*

6. PËRGATITJA E FORMULARIT

Institucioni: *QRTK - Prishtinë*

Hartuesit e formularit: *Merita Gorani Bajri Ing. dipl. Ark.*
Agim Halili Tek. ndërtimtarisë - konzervator

Personi i autorizuar:

Adresa dhe kontakti: *rr. Agim Ramadani, 10 000 Prishtinë*

Data: *.../.../.....*

Nënshkrimi: *.....*